



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Pergjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400589/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasës D.M.*

Drejtuar : **Z. Arsim RAMA**
Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve
Shoqërore

TIRANË

Zoti Drejtor,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja *D.M.*, lidhur me mosmarrje të përgjigjes për kërkesën e saj për rishqyrtim të masës së pensionit të pleqërisë.

Sipas shpjegimeve të saj, bazuar në vjetërsinë e pënës, prej 39.5 vitesh, ankuesja pretendon se masa e pensionit duhet të jetë më e madhe nga sa i është caktuar. Ka bërë kërkesë pranë institucionit tuaj për rishqyrtim pensioni më datë 15.07.2013, por nuk i është kthyer asnjë përgjigje. Më pas i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe më datë 23.10.2013 është njoftuar se në përgjigje të kërkesës së saj dosja e pensionit me rekomandimet përkatëse është dërguar për shqyrtim pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Pavarësisht interesimit të vazhdueshëm të saj, nuk ka marrë përgjigje zyrtare apo sqaruar verbalisht.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të ligjshme të tij, ankuesi ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për të mundësuar rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike,

si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “*Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

Rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë të shtetases D.M.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj ktij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI